



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**  
**Komisioni**

Nr \_\_\_\_\_ prot.

Gramsh, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Në bazë të Urdhërit të Kryetarit nr 47. Datë 06.02.2024, për ngritjen e “Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e Fondit Limit”, me objekt prokurimi “pjesë këmbimi të automjeteve të administratës, drejtorive dhe sektorëve në varësi” më poshte komisioni ka renditur specifikimet e duhura teknike për pjesët e këmbimit të automjeteve të administratës së bashkisë dhe sektorëve vartës të nevojshme për vitin 2024.

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknike etj: **SIPAS KERKESAVE TE PERCAKTUAR NE PREVENTIV SIPAS LLOJIT TE MJETEVE**

**Mallrat duhet të jenë të cilësisë së lartë**

**Për të gjitha materialet sipas preventive operatori ekonomik detyrimisht së bashku me mallrat duhet të paraqesë për secilin artikull apo grup artikujsh Certifikatën e Origjinës së mallit nga Prodhuesi i tyre.**

1. Mallrat objekt i këtij prokurimi duhen të jenë: origjinale, të plotësojnë të gjitha kërkesat gjeometrike, funksionale dhe të përdorimit të përcaktuara nga prodhuesi.
2. Mallrat objekti këtij tenderi duhen të plotësojnë normativat europiane sipas standartit **ISO-9001-2015**.
3. Garancia e pjesëve të këmbimit të jetë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga momenti i vënies në punë të tyre. Çertifikata e garancisë së pjesëve të këmbimit të jetë e plotësuar dhe të shoqërojë mallin në momentin e dorëzimit të tij.
4. Të gjitha pjesët e këmbimit të jenë të ambalazuara në kuti kartoni apo veshje plastike si dhe të kenë përcaktim të mirë në etiketë për llojin, markën e tyre, bulonat dhe fermo.
5. Vajrat e mjeteve të jenë të gjitha sipas tipeve të tyre.
6. Të gjithë artikujt e pjesëve të këmbimit të jenë sipas tipeve të mjeteve.
7. Mosplotësimi i kushteve të mësipërme përbën kusht për skualifikim.